



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 4, datë 29.12.2016

**PËR**  
**MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,**  
**BASHKIA LUSHNJE**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 58 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Lushnje si dhe referuar vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 95, datë 25.11.2016, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Dokumentit të “Planit të Përgjithshëm Vendor”, Bashkia Lushnje.
2. Plani i Përgjithshëm Vendor përbëhet nga dokumentet si vijon:
  - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
  - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
  - c) Rregullorja e Planit;
  - d) Materiali hartografik:
    - i. Vizioni strategjik;
    - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
    - iii. Ndarja e territorit në njësi;
    - iv. Përdorimi i propozuar i tokës sipas 14 kategorive bazë;
    - v. Infrastruktura e transportit;
    - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
3. Autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara për Zonat me Rëndësi Kombëtare është Këshilli Kombëtar i Territorit, me propozim të Ministrit përgjegjës.
4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Lushnje duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.

5. Ngarkohet Bashkia Lushnje për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen dokumentet e planifikimit / studimet urbanistike të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të bashkisë Lushnje, përfshirë si më poshtë:
  - Vendim Nr. 41, datë 27.12.1994 i KRRTRSH-së, “Për studimin urbanistik pjesor për zonën trekëndëshe përballë uzinës së plastmasit në Lushnje”;
  - Vendim Nr. 55, datë 27.12.1994 i KRRTRSH-së “Për Studim Urbanistik për zgjerimin e vijës kufizuese të qytetit të Lushnjes”;
  - Vendim Nr. 2, datë 07.05.2003 i KRRTRSH-së “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Lushnjes dhe vijën kufizuese të kesaj qendre”;
  - Vendim Nr. 2, datë 01.06.2012 i KKT-së “Plani i Përgjithshëm Vendor Lushnje”
7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMEZI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

